



Qendra për Politika dhe Avokim Center for Policies and Advocacy

Projekti: “Për një mjedis të pastër”

Komuna: HAN I ELEZIT

Periudha: Shtator-Dhjetor, 2009

Foto e komunës



<http://static.panoramio.com/>

Botues:



Qendra për Politika dhe Avokim
Center for Policies and Advocacy

Hartues të Raportit:

Tafë Veselaj dhe Aferdita Maliqi

Hulumtues në terren:

Milaim Morina
Drilon Dobruna
Valentina Hyseni
Albulena Berisha

Redaktore:

Shqipe Pantina

Mbështetur nga:



"Ky projekt u financua përmes grantit të Departamentit të Shtetit të SHBA-ve. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit të SHBA-ve."

I. Hyrje

Problemet e mjedisit dhe mbrojtja e tij janë ndër çështjet më shqetësuese me të cilat sot po ballafaqohen qeveritë e shteteve në të gjithë botën, ndërkaq veçanërisht ngrohja golbale po bëhet një shqetësim serioz për globin tokësor.

Në Kosovë, çështja e mjedisit, për fat të keq, për një kohë të gjatë nuk ka qenë në listën e prioriteteve. Ndërkohë, mbrojtja e mjedisit ende nuk zë hapësirën dhe rëndësinë e duhur në agjendat e politikbërësve qoftë në nivelin qendror, por veçanërisht në atë lokal.

Qendra për Politika dhe Avokim (QPA), në këtë raport, i cili është hartuar në kohën e fushatës parazgjedhore të zgjedhjeve lokale të nëntorit 2009, prezenton një përmbledhje të shkurtër për gjendjen e mjedisit në Komunën e Hanit të Elezit, infrastrukturën ligjore që rregullon fushën e mjedisit, qasjen e partive politike për çështjet mjedisore dhe në fund rekomandimet, që janë dalë nga tryeza e organizuar për mjedisin, e që kanë synim përmirësimin e kësaj gjendje.

Raporti është pjesë e projektit “Për një mjedis të pastër”, i cili është mbështetur nga Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë, të cilën e falënderojmë përzemërisht. Po ashtu, QPA falënderon thellësisht përfaqësuesit e partive politike të Komunës së Hanit të Elezitt, Organizatat Joqeveritare, si dhe qytetarët, të cilët kanë kontribuar me komentet dhe rekomandimet e tyre.

Veçanërisht falënderojmë kandidatët e partive politike për kryetar të komunës së Hanit të Elezit si Menduh Vllahi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Refki Suma kandidat i pavarur, Zylbehar Asallari kandidat për Asamble Komunale nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Shaban Qupi kandidat për Asamble nga Partia Demokratike e Kosovës, Nuriman Kuka, si dhe përfaqësues të OJQ-së ”Antikos”, të cilët kontribuan me rekomandimet dhe vërejtjet e tyre.

QPA po ashtu thellësisht falënderon ata që bënë të mundur jo vetëm hartimin e këtij raporti, por edhe gjithë zbatimin e projektit “Për një mjedis të pastër”: Menaxheren e Projektit, Afërdita Maliqi, ekspertin për çështje mjedisore, Tafë Veselaj, si dhe hulumtuesit Drilon Dobruna, Milaim Morina dhe Valentina Hyseni.

II. Komuna e Hanit të Elezit - karakteristikat dhe veçoritë



<http://www.hanielezit-komuna.org/>

Hani i Elezit, dikur pjesë e Komunës së Kaçanikut, përbëhet nga 10 fshatra dhe një njësi urbane. Kjo komunë ka një shtrirje gjeografike të veçantë, ku vendbanimi urban gjendet në mes të një grope gjeografike, kurse fshatrat gjenden përreth në lartësi mbidetare nga 400 deri 800 metra lartësi. Hani i Elezit është njëra ndër tri komunat e reja, të cilat janë formuar më 2005¹ dhe ka mbi 10 mijë banorë.

Edhe pse e formuar që nga 2005, qytetarët e Komunës së Hanit të Elezit nuk kanë pasur rastin që të votojnë për komunën e tyre, andaj më 15 nëntor Hani i Elezit do të zgjedhë për herë të parë Kryetarin e Komunës dhe Asamblenë Komunale.

Hani i Elezit konsiderohet si komunë industriale dhe përballet me probleme serioze të ndotjes së mjedisit. Ndotja e ajrit nga industria, ndotja e ujërave nga derdhja e kanalizimeve fekale të patrajuara, ndotjet kimike si pasojë e ekzistencës së industrisë së rëndë, mungesa e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, mungesa e hapësirave të gjelbëruara, shfrytëzimi i resurseve natyrore, janë problemet kryesore mjedisore në territorin e Komunës.

¹ www.institutigap.org, raporti komunal

Për shkak të ndotjes së madhe të mjedisit, si pasojë e shkretitores që gjendet në këtë komunë, një numër i qytetarëve të këtij lokaliteti, në krahasim me komunat tjera, vuajnë nga sëmundje të ndryshme.

II.1. Gjendja aktuale në fushën e mjedisit

Komuna e Hanit të Elezit renditet në mesin e komunave të vogla të Kosovës. Kjo komunë është e pasur me resurse natyrore e sidomos ato të prodhimit të materialit ndërtimor. Materiali Mergel guri gëlqeror, argjilë, etj., gjithashtu janë resurse të mjaftueshme të pyjeve dhe ujërave, si dhe sasi mesatare të tokës bujqësore.

Sipërfaqja e përgjithshme tokësore e Komunës së Hanit të Elezit është 8294 ha. Prej kësaj tokë bujqësore 2915 ha, pyje 4842 ha, tokë e jobujqësore 6.13 ha².

Mjedisi dhe Industria: Hani i Elezit konsiderohet si komunë industriale, ku edhe funksionon fabrika më e njohur e prodhimit të çimentos në Kosovë. Përveç kompanive publike, shumica e tyre janë privatizuar apo janë dhënë me koncesion. Në Han të Elezit funksionojnë edhe një numër i konsiderueshëm i bizneseve private, që si të regjistruara janë 250 biznese të vogla dhe të mesme³.

Ndikimet e veprimtarive industriale janë evidente në tokë, ajër, ujë, gjithashtu edhe në peizazh, si pasojë e shfrytëzimit të resurseve natyrore. Që prej themelimit të Fabrikës për prodhimin e Çimentos, më 1936, Hani i Elezit mbetet një ndër pikat më të nxehta ose “*Hot spot*” për nga niveli i ndotjes në Kosovë.

Me gjithë përmirësimet në teknologjinë e Fabrikës akoma është evidente ndotja e ambientit, kurse ende ndihen pasojat e së kaluarës kur kjo trevë kishte një ndotje të konsiderueshme. Kësaj ndotje në masë të madhe i ka kontribuar edhe ekzistenca e fabrikës së prodhimeve nga azbest çimentoja.

Emetimi i gazrave si: CO₂, SO₂ dhe Nox paraqet një ndotje shumë serioze të ajrit nga veprimtaritë industriale, ndërkohë që këta ndotës kontrollohen vetëm nëpërmjet matjeve të vetë Fabrikës “SharrCem”, e cila është edhe ndotësi kryesor në këtë aspekt.

Sipas të dhënave nga vetëmonitorimi që e bënë SharrCemi, vlera mesatare për emisionet e pluhurit ka rezultuar 78 mg/Nm³, vlera mesatare vjetore e emisionit të SO₂ ka rezultuar 235 mg/Nm³ dhe vlera mesatare e NOX ka rezultuar 608 mg/Nm³.

Këto janë matje të bëra në vitin 2008 dy herë brenda vitit dhe jo monitorim i vazhdueshëm. Në bazë të këtyre të dhënave del se vlera mesatare e pluhurit ka kaluar limitet e caktuara sipas ligjeve ekzistuese në fuqi.

² Strategjia për zhvillimin socioekonomik të Hanit të Elezit 2008 – 2012 (Maj 2008)

³ Instituti për Studime të Avancuara GAP, Hani i Elezit – Raporti komunal, Tetor 2009

Ndotja e lumit Lepenc dhe përrenjve vjen nga derdhja e kanalizimeve fekale të patrajtuara, si dhe ndotjet kimike si pasojë e ekzistencës së industrisë së tanishme apo edhe mbetjeve të tyre. Në bazë të hulumtimeve dhe matjeve të fundit mbi aspektet kimike dhe bakteriologjike, kualiteti i lumit Lepenc bie në kategorinë e katërt të ujërave, në bazë të standardeve mbi kualitetin e ujërave.

Rrezikshmëria më e madhe paraqitet në deponimin e mbeturinave të ngurta dhe atyre toksike kancerogjene të mbetjeve nga prodhimet e azbest-çimentos, të cilat mund të hasen me shumicë përgjatë pellgut të lumit në gjithë hapësirën e këtij lokaliteti⁴.

Uji dhe Mbeturinat: Pasuritë ujore të Komunës së Hanit të Elezit janë të mëdha, por mungesa e planifikimit dhe e mjeteve materiale ka bërë që shfrytëzimi i atyre burimeve të jetë minimal dhe me këtë ndihet edhe mungesa serioze në furnizim të qytetarëve me ujë të pijes.

Ekzistojnë dy sisteme të ujësjellësit në Han të Elezit që janë të përziera në mes vete. Në ndërkohë sistemi i vjetër nuk është mirëmbajtur sa duhet dhe uji sipërfaqësor hyn në gypa pa u trajtuar fare, për shkak të dëmtimit të stabilimenteve⁵.

Nga këto fakte mund të konkludojmë se ndotjes së ujësjellësit në Han të Elezit i ka ndihmuar në masë të konsiderueshme edhe përzierja fizike e dy sistemeve të ujësjellësit. Fshatrat janë pa sisteme të përbashkëta të ujësjellësit dhe janë të organizuara si sisteme individuale, duke shfrytëzuar burimet private që menaxhohen tërësisht prej tyre.

Janë rreth 1800 metra kanalizim në Han të Elezit dhe të gjitha ato derdhen në lumin Lepenc pa kurrë farë trajtimi. Në fshatin Guran gjithashtu kemi sistemin e kanalizimit fekal, kurse në fshatrat tjera të gjitha ujërat e zeza trajtohen individualisht dhe në raste të shumta me derdhje sipërfaqësore, që mund të ndikojë në paraqitjen e sëmundjeve të ndryshme. Ndryshe, sistemi i kanalizimeve në Han të Elezit nuk menaxhohet fare.

Mbledhja e mbeturinave të ngurta gjithashtu është një ndër problemet më serioze të këtij lokaliteti. Praktikisht hedhje të mbeturinave kemi gati në çdo qosh të qytetit, por edhe fshatrat nuk janë në gjendje më të favorshme.

Një kompani vendase bën mbledhjen e mbeturinave, por vetëm me të nuk është mundur të arrihet asnjë marrëveshje nga Administrata Komunale. Si pasojë e kësaj, vullneti i kësaj Kompanie varet kryekëput nga përqindja e pagesave të qytetarëve për këtë shërbim.

⁴ Strategjia për zhvillimin social ekonomik të Hanit të Elezit 2008 – 2012 (Maj 2008)

⁵ Strategjia për zhvillimin social ekonomik të Hanit të Elezit 2008 – 2012 (Maj 2008)

II.2. Infrastruktura ligjore në fushën e mjedisit

Kuvendi i Kosovës deri më sot ka miratuar ligje që rregullojnë mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës dhe ato që ndërlidhen me ndikimet në mjedis. Pothuajse janë 32 ligje të tilla. Ligjet më të rëndësishme për mjedisin që zbatohen në Komunën e Hanit të Elezit janë:

- Ligji për vetëqeverisje lokale
- Ligji për mbrojtjen e mjedisit
- Ligji për ujërat e Kosovës
- Ligji për mbeturinat
- Ligji për mbrojtjen e natyrës
- Ligji për planifikimin hapësinor
- Ligji për pyjet e Kosovës
- Ligji për gjuetinë
- Ligji për peshkatari dhe akuakulturë, si dhe shume akte tjera nënligjore.

Komuna e Hanit të Elezit e ka të aprovuar edhe Statutin në bazë të nenit 12, alineja 12.2 dhe 12.3 të Ligjit për vetëqeverisje lokale. Statuti që është aprovuar në dhjetor të vitit 2008 është dokumenti më i lartë që ka të bëjë me funksionalitetin dhe përgjegjësitë e Komunës, ku përcaktohet edhe mbrojtja e mjedisit.

Në maj të vitit 2008, është miratuar Strategjia për zhvillimin social ekonomik të Hanit të Elezit 2008 – 2012, por nuk ka ndonjë rregullore apo plan tjetër për mjedis.

II.3. Institucionet përgjegjëse dhe mekanizmat për mbrojtjen e mjedisit

Asambleja e Komunës së Hanit të Elezit është institucioni më i lartë komunal dhe vendimmarrës, që përbëhet prej 15 anëtarëve dhe ka Kryetarin dhe zëvendëskryetarin e Komunës. Administrata lokale është e organizuar në gjashtë Drejtori, ndërkaq përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit është Drejtoria për urbanizëm, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit⁶, në kuadër të së cilës vepron edhe një zyrtar për mbrojtjen e ambientit dhe inspektim si dhe zyrtari për inspeksion.

Po ashtu, përgjegjësi për mjedisin kanë edhe drejtoritë e tjera si p.sh., ajo e Shërbimeve Publike.

Shoqëria civile në këtë komunë nuk është e organizuar sa duhet, numi i OJQ-ve është relativisht i ultë, kurse ndër organizatat më aktive në këtë komunë mund të veçojmë “Progresi për Demokraci”.

⁶ <http://hanielezit-komuna.org/urbanizmi.php>

III. Platformat politike të partive politike për çështjen e mjedisit

Subjektet politike që garojnë në zgjedhjet lokale të 15 nëntorit 2009 kanë pasur një qasje më konkrete për problemet e mjedisit, ndoshta edhe për shkak se tashmë një kohë të gjatë popullata e kësaj komunë vuan nga problemet mjedisore.

Ndonëse platformat politike shpeshherë nuk janë të hapura për opinionin, megjithatë në debatin që QPA ka mbajtur në Han të Elezit me partitë garuese në zgjedhjet lokale, të gjitha partitë pjesëmarrëse kanë paraqitur si objektiv të tyre përmirësimin e ambientit. (QPA ka siguruar platformat politike, ku i kushtohet rëndësi ambientit, të partive LDK, AAK - shih aneksin).

Qendra për Politika dhe Avokim, më 17 tetor, ka organizuar një debat në Han të Elezit me përfaqësuesit e partive politike, që garojnë në zgjedhjet e 15 nëntorit 2009, përfaqësuesit e të cilave kanë shpalosur objektivat, planet, prioritetet dhe premtimet e tyre për përmirësimin e mjedisit.

Në debatin me titull "Për një mjedis të pastër", kanë marrë pjesë këto subjekte politike: PDK, LDK, AAK dhe kandidati i pavarur Refki Suma.

a) Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në debat është përfaqësuar nga z. Shaban Çupi, kryesuesi aktual i Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit, si dhe kryetari i degës së PDK-së, z. Myfail Suma, kandidat për Asamble Komunale.

Çupi ka theksuar se ndotja e mjedisit vije nga Fabrika së Çimentos së Shar-cem. "Programi i PDK-së është krijimi i një zonë ndarëse të gjelbërt ndërmjet Fabrikës e qytetit dhe pastrimi i lumit Lepenc nga mbeturinat e asbestit. Ndërsa në bashkëpunim me Caritasin e Luksemburgut parashihet ripyllëzimi dhe ngritja e një deponie të mbeturinave bashkë me komunat tjera", tha Çupi, derisa përmendi edhe nevojën e forcimit të masave ligjore për mbrojtjen e ambientit.

Ndërkaq, kryetari i degës së PDK-së, z. Myfail Suma, shprehu shqetësimin e tij për ndotjen e madhe të ambientit, duke thënë se "deri pas luftës nuk është ditur se asbesti është i rrezikshëm, por pas luftës me ndihmën e KFOR-it Amerikan u kuptua që asbesti ka substancë kancerogjene".

Sipas tij, nga 1000 punëtorë deri më tani 100 kanë vdekur si rezultat i asbestit, sëmundjet psikiatrike janë të pranishme 13.7%, ndërsa ato të mushkërive 40%. Ai tha se problem për ndotjen e mjedisit paraqet edhe hedhja e mbeturinave pa kontroll sidomos rreth lumit Lepenc, prerja e pyjeve etj.

Sipas përfaqësuesve të PDK, programi politik i PDK për mjedis ka për synim një ambient të pastër ekologjik, si dhe t'u kthehet imazhi i bukur natyror lumenjve.

PDK do të angazhohet në instalimin e një sistemi të monitorimit për matjen e ndotjes së ajrit, futjen e fshatrave në menaxhim të mbeturinave, pastrimin e lumit Lepenc nga mbeturinat e asbestit dhe ndotësve tjerë, ndërtimin e një impianti për përpunimin e ujërave të zeza, forcimin e infrastrukturës ligjore, zgjerimin me sipërfaqe të gjelbëruara etj.

b) Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në debat është përfaqësuar nga z. Zylbehar Hasallari, i cili theksoi se platforma e këtij subjekti parasheh gjelbërimin e sipërfaqeve si një mënyrë për mbrojtjen e mjedisit.

Hasallari tha se nëse LDK-ja e merr udhëheqjen e Komunës së Hanit të Elezit do të kërkojë në mënyrë të prerë zbatimin e rregullores për mbrojtjen e mjedisit (e cila tani nuk zbatohet), hapjen e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza para se të hidhen në lumin Lepenc, si dhe planifikon vetëdijesimin e qytetarëve jo vetëm në qytet, por edhe nëpër zonat rurale për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.

Përfaqësuesi i LDK-së propozoi edhe krijimin e një Departamenti për ambient në kuadër të komunës, ndërkaq theksoi rëndësinë edhe të sektorit të turizmit që ka për këtë komunë.

LDK ndër prioritetet për zgjidhjen e problemeve mjedisore ka paraparë zhvillimin rural, monitorimin e ajrit, urbanizmin dhe zhvillimin urban, kanalizimet dhe rrjetin e ujësjellësit, shfrytëzimin eficient të tokës bujqësore, zonat e mbrojtura natyrore, pyllëzimin dhe ruajtjen e pyjeve, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e lumenjve etj.

c) Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në debat është përfaqësuar nga z. Menduh Vlasi, kandidat për kryetar të komunës, i cili derisa përmendi problemet mjedisore në këtë komunë, tha se ato vijnë nga Fabrika e Çimentos, Fabrika e Gëlqeres, e Silkapor-it etj. Vlasi gjithashtu tha se gjendja e ujërave është e papërshtatshme, ndërkohë që as mbeturinat nuk kanë kontroll të menaxhimit dhe që të gjitha hidhen dhe derdhen në lumin Lepenc, që tani është shndërruar në një kolektor.

Situatën e paraqiti mjaft të keqe në aspektin e ndotjes së ajrit sidomos nga Sharrçemi, ku nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ishte kërkuar një monitorim më strikt. Vlasi premtoi se nëse AAK-ja vjen në pushtet nuk do të lejojë pluhur në këtë qytet, sepse, siç u shpreh ai, “më e rëndësishme është jeta e qytetarit sesa përfitimet dhe interesat e disa individëve”.

d) Kandidati i Pavarur - Refki Suma, kandidat për Kryetar të Komunës, gjendjen e mjedisit e sidomos të ndotjes së ajrit e paraqiti si të rëndë, por premtoi se me ardhjen e tij në pushtet do të bëhen investime për sistemin e monitorimit të ajrit.

Në veçanti ai tha se do të angazhohet që të pengohet prerja e pyjeve, si dhe të respektohet ligji.

Në debat ishte i pranishëm edhe drejtori i ndërmarrjes “Higjiena”, z. Nuredin Qupi, sipas të cilit kjo ndërmarrje menaxhon 80% të territorit të Hanit të Elezit dhe problemet janë të shumta që nga menaxhimi me mbeturinat e deri te pagesat.

IV. Rekomandimet

Rekomandimet e dala nga tryeza “Për një mjedis të pastër”;

- Ndërtimi i një impianti për trajtimin e ujërave të përdorura urbane
- Vendosja e sistemit të monitorimit të ajrit
- Futja e fshatrave nën menaxhim të mbeturinave
- Sistemin e kanalizimit dhe ujësjellësit
- Pastrimi i lumit Lepenc nga mbetjet e asbestit
- Formimi i një Drejtorie të veçantë për mjedisin
- Zhvillimii rural dhe urbanizimi
- Shfrytëzimi eficient i tokës bujqësore
- Zonat e mbrojtura natyrore, pyllëzimi dhe ruajtja e pyjeve
- Mirëmbajtja dhe ruajtja e lumenjve
- Pastrimi i lumit Lepenc nga mbeturinat e asbestit dhe ndotësve tjerë
- Forcimi i infrastrukturës ligjore
- Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbëruara etj.



Projekti “Për një mjedis të pastër” i mbështetur nga Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë